



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

20.09.2023 viti god vepr.

Pranuar / Dorezuar Primjeno / Prodato Received / Delivery	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
	6167/2023		1/1



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A nr. 1137/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Eshref Shabani, anëtarë me Rushit Kajtazi - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr. 1137/2023 të datës 04.09.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] kundër Komunës së Kaçanikut, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 20.09.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën A.nr. 1137/2023 të datës 04.09.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave në Komunën e Kaçanikut.

**A r s y e t i m**

Ankuesja [redacted] më datë 04.09.2023, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5935/2023, e regjistruar nën shenjen A. nr.1137/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit për pozitën e punës *Drejtor i Qendrës për Edukim dhe Arsim Parashkollor në QEAP "Agimi"* në Kaçanik.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke marrë parasysh faktin se objekt i kësaj çështje ankimore është procedura e rekrutimit për pozitën e punës *Drejtor i Qendrës për Edukim*



dhe Arsim Parashkollor në QEAP "Agimi", konstatoi se Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, sepse:

Me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 2 paragrafi 3 përcaktohet se 3. **Nëpunës civil** - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë, ndërsa me paragrafin 4 të këtij neni përcaktohet se: 4. **Nëpunës i Shërbimit Publik** - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime tjera të ngjashme publike, nga rrjedh se zyrtarët publik të nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Edukativo Arsimore, ku benë pjese edhe pozita e punës Drejtor i Qendrës për Edukim dhe Arsim Parashkollor në QEAP "Agimi" e kanë statusin e nëpunësit të Shërbimit Publikë, ndërsa kandidatet për pranim në pozitat përkatëse në kuadër të Institucioneve Edukativo Arsimore synojnë ta marrin statusin e nëpunësit të Shërbimit Publikë.

Andaj, për sa me sipër konstatohet se ankuesja nuk e ka statusin e nëpunësit civil, dhe si rrjedhojë as të kandidatit për pranim në Shërbimin Civil dhe për pasojë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën A.nr. 1137/2023 të datës 04.09.2023 të parashtruar nga ankuesja [REDACTED], ngase bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, Këshilli shqyrton dhe vendos vetëm për ankesat e parashtruara nga nëpunësit civil dhe kandidatët për pranim në Shërbimin Civil.

Kështu që pas konstatimit si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr. 1137/2023 të datës 04.09.2023 dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se pala ankuese nuk ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1137/2023 të datës 04.09.2023 dhe të bartë lëndën të organi kompetent, në këtë rast Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Komunën e Kaçanikut.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetar i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.1137/2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Jeton KOCA

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Kaçanikut;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kaçanikut;
- Arkivit të KPMSHCK-së.